

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit L. A. nga fshati L. e U. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK, iniciuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1716-7/2016 të datës 24.10.2016, në seancën fillestare në praninë e prokurorit të shtetit Sahide Sefa, të akuzuarit, të dëmtuarës K. A. nga fshati L. e U. Komuna e Prizrenit dhe përkthyesit të gjykatës prof. Fejzullah Shatri, me datë 25.08.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**L. A.** nga i ati V. dhe e ëma A. e lindur M., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin L. e U. Komuna e Prizrenit, ku dhe tani jeton, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, punëtor i ndërtimtarisë – murator tani në pension, i martuar, babai katër fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

### ËSHTË FAJTOR

Me datë 23.06.2016 rreth orës 17:00, në shtëpinë e tyre familjare e cila gjendet në fshatin L. e U. Komuna e Prizrenit, i shkakton lëndime trupore bashkëshortes së tij – të dëmtuarës K. A., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjes lidhur me kafshët shtëpiak dhe kujdesin ndaj tyre e godet në kokë, ashtu që të dëmtuarës i shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta të kokës, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

#### **Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 188 par.1 të KPK të akuzuarit i shqipton:

### DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (muaj) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprën penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike – është pensionist, prandaj lirohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen material të akuzuarit dhe anëtarëve të familjes.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 150 par.1 të LESP.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1716-7/2016 të datës 24.10.2016, kundër të akuzuarit L. A. nga fshati L. e U. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit, i njëjti u deklarua se ka kuptuar aktakuzën, nuk e kundërshton provat materiale dhe e ndjen veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 23.06.2016 në orët e pasdites rreth orës 17:00, në fshatin L. e U. Komuna e Prizren – konkretisht në shtëpinë e tyre, i akuzuari L. A. për shkak të mosmarrëveshjes me bashkëshorten e tij të dëmtuarën K. A., rreth punëve të shtëpisë lidhur me kujdesin ndaj bagëtisë, fillimisht fjalosen e më pas sulmon fizikisht e godet në kokë dhe i shkakton lëndime trupore të dëmtuarës dhe atë: ndrydhje të indeve të buta të kokës, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga e akuzuari për veprimet e përshkruar si në përshkrimin faktik të aktakuzës, me ç'rast edhe nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, sepse mbështet në fakte që përmban aktakuza nga se i akuzuari prej fillimit të kësaj procedure ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës, të cilat prova nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpalli fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, është i gjendjes së varfër ekonomike dhe mbajtës i familjes, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**P.nr.2281/2016 të datës 25.08.2017**

**Procesmbajtësja  
Myrvete Përdibuika**

**Gjyqtarja  
Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.